Sfidat e bizneseve për kyçje në rrjet të energjisë elektrike në Kosovë

Perspektiva e konsumatorëve dhe prodhuesve

Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

Përgatitur nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

Prishtinë, Kosovë

Shtator 2024

Hyrje 3
Sektori i energjisë në Kosovë 4
Programi i Qeverisë 2021-2025 4
Strategjia për energji 2022 – 2031 4
Narrativat nga bizneset 5
Perspektiva e konsumatorëve në kyçjen në rrjet të distribucionit 5
Perspektiva e prodhuesve (gjeneruesve) të energjisë per kycje ne rrjet te transmisionit 6
Sqarimi nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë 7
Koment nga zhvilluesit e sistemeve fotovoltaike 7
Korniza regullatore për kyçjen në rrjet të shpërndarjes 8
Metodologjia e taksave për kyçje në rrjetin e shpërndarjes 8
Rekomandimet 11

Hyrje

Sektori i energjisë në Kosovë luan një rol jetik në zhvillimin ekonomik të vendit. Qasja në një rrjet të qëndrueshëm elektrik është thelbësore për prosperitetin e bizneseve. Megjithatë, bizneset përballen me sfida të ndryshme kur përpiqen të kyçen në rrjet. Këto sfida ndryshojnë varësisht nëse kompanitë janë prodhues ose konsumatorë të energjisë.

Sistemi i shpërndarjes së energjisë rregullohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, e cila autorizon KEDS-in të investojë deri në 20 milion euro në vit për përmirësime dhe zgjerime të rrjetit të shpërndarjes. Nje nga arsyet pse kjo shume është vendosur ka të bëjë me kufizime të kapaciteteve të brendshme të KEDS që të realizojë projekte në vlerë më të madhe se kjo shumë (përafërsisht). Në anën tjeter edhe nëse investimet kalojnë një shumë të konsiderueshme nga ky aprovim (rreth 20 mil Euro), potencialisht do të mund të ndikojnë që tarifat e energjise elektrike të rriten, gjë që do të kishte ndikim te konsumatorët.

Sfidat shfaqen veçanërisht për bizneset që përpiqen të krijojnë ose të zgjerojnë kapacitetin e prodhimit në objekte të reja. Në varësi të vendndodhjes së tyre:

- Disa biznese kanë qasje relativisht të lehtë në rrjet – kur vendndodhja është favorshme.
- Disa biznese duhet të bëjnë investime të konsiderueshme në infrastrukturën e rrjetit elektrik, siç janë zgjatja e linjave të energjisë ose ndërtimi i nënstacioneve, për të përmbushur nevojat e tyre për energji elektrike – kur vendndodhja është e pafavorshme.

Kjo ka çuar në një situatë ku kompanitë bartin barrën e përmirësimit dhe zgjerimit të rrjetit me shpenzimet e tyre, pa u kompensuar përmes tarifave të energjisë. Ndërkohë, projektet e ngjashme të zgjerimit të rrjetit të realizuara nga KEDS pasqyrohen në tarifat e konsumatorëve.

Adresimi i këtij problemi do të kërkojë një rishikim të mënyrës se si financohen investimet për zgjerimin e rrjetit, pasi sistemi aktual i vë bizneset e reja dhe ato ekzistuese që kërkojnë të rrisin kapacitetet prodhuese në disavantazh, duke penguar rritjen dhe konkurrueshmërinë e tyre në Kosovë.

Prandaj, ky raport synon të theksojë sfidat kryesore me të cilat përballen bizneset në kyçjen në rrjet të energjisë në Kosovë, si dhe të propozojë disa zgjidhje praktike për të lehtësuar këtë proces. Edhe pse ky raport fokusohet më shumë në sfidat e kyçjes në rrjetin e distribucionit, poashtu paraqet edhe kërkesat dhe shqetësimet e ngritura nga bizneset lidhur me kyçjen në rrjetin e transmisionit.

Pavarësisht përpjekjeve të institucioneve përgjegjëse në ndryshimin e kornizës ligjore dhe ngritjes së efikasitetit, disa nga barrierat e natyrës administrative dhe mungesa e qartësisë dhe unifikimit të kornizës ligjore vazhdojnë të pengojnë investimet e reja dhe një klimë të mire të të bërit biznes.

Raporti përmban rekomandime konkrete për lehtësimin e kyçjes në rrjet dhe ofron disa propozime për ndryshim të politikave, me theks të veçantë në krijimin e një qasje më të koordinuar dhe të unifikuar mes të gjithë akterëve relevant të këtij sektori.

Sektori i energjisë në Kosovë

Sistemi i energjisë elektrike në Kosovë përfshin gjenerimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë. Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) monitoron zhvillimin e sistemit, licencimin e kompanive dhe rregullon çmimin për konsumatorët fundorë.

KOSTT-i, në pronësi të Kuvendit të Kosovës, është përgjegjës për transmetimin dhe menaxhimin e rrjetit, ndërsa KEDS-i, si operator privat, merret me shpërndarjen e energjisë. Ndërkaq, ndër 7 furnizuesit e licencuar të energjisë, KESCO ka obligimin e shërbimit publik për furnizim, i përcaktuar nga Rregullatori.

Programi i Qeverisë 2021-2025

Përmes Programit të saj për vitet 2021-2025, Qeveria ka komunikuar vizionin për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji për qytetarët dhe ndërmarrjet, duke përmirësuar menaxhimin e kapaciteteve ekzistuese dhe duke ndikuar pozitivisht në mjedis.

Strategjia për energji 2022 – 2031

Strategjia e Energjisë e Kosovës synon një sektor të qëndrueshëm të energjisë dhe të integruar në tregun Pan-Evropian, duke rritur besueshmërinë dhe sigurinë e furnizimit përmes modernizimit të rrjetit, investimeve në kapacitete të reja dhe sigurisë së furnizimit.

Për të arritur objektivat strategjike si më sipër, është planifikuar 1) të rritet fleksibiliteti i sistemit; 2) të modernizohet rrjeti dhe të zvogëlohen humbjet në rrjet; 3) të bëhet revitalizimi i kapaciteteve ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike dhe investimet në kapacitete të reja, dhe 4) të arrihet siguria kibernetike e sektorit të energjisë.

Narrativat nga bizneset

Pjesa në vijim e raportit përmbledh disa përshkrime nga bizneset lidhur me përvojat e tyre me kyçjen në rrjet të energjisë.

PJESA 1

Perspektiva e konsumatorëve në kyçjen në rrjet të distribucionit

Si shembull, një kompani ka treguar se, si rezultat i mungesës së kapacitetit të mjaftueshëm me energji në zonën ku kanë hapur fabrikën, kompania është obliguar të hapë, si investim privat, një kanal nëntokësor në gjatësi 3 km për të marrë furnizmin e nevojshëm me rrymë. Aktualisht, për shkak se është rritur numri i banorëve të zonës dhe të gjithë janë kyçur në atë lidhje, fabrika e kësaj kompanie më nuk furnizohet me rrymë të mjaftueshme nga lidhja të cilën e kanë krijuar vetë.

Në një tjetër rast, përmes aplikimit të parë në KEDS, kjo kompani kishte kërkuar një fuqi të njëkohshme prej 420 kW dhe një trafo me kapacitet prej 630 kVA. Përderisa pëlqimi i parë elektroenergjetik (2022) u mor për lidhje në tensionin 10 kV, kompania më vonë kërkoi revidim të projektit për shkak të pengesave në terren, si rruga e ngushtë dhe prona private. Pëlqimi u revidua për një fuqi të instaluar prej 160 kVA dhe 120 kW, me lidhje afër fabrikës. Për shkak të nevojave për rritje të kapacitetit, u kërkua sërish rritje në 420 kW, por projektet e propozuara nga KEDS u konsideruan të parealizueshme nga të gjithë operatorët përkatës, për shkak të kushteve teknike dhe terrenit të vështirë.

Në këtë moment, KEDS kishte ofruar të realizonte vetë projektin me një kosto prej 179,362.67€, me c'rast të gjitha asetet e ndërtuara do t'i transferoheshin KEDS-it si mjete themelore.

Si përfundim, për të adresuar problemin përkohësisht, për të arritur energjinë me fuqi të nevojshme, kompania ka instaluar një sistem të energjisë solare (300 kW), dy gjeneratorë (630 kVA; 100 kVA), si dhe duke shfrytëzuar rrjetin e KEDS prej 120 kW.

Në një shembull tjetër, një kompani ka informuar se pas zgjerimit të kapacitetit prodhues në fabrikë për prodhim të ujit, ka kërkuar rritjen e furnizimit me energji nga 0.4 kV në furnizim me 10 kV, përmes një kërkese drejtuar KEDS-it. Për shkak të kufizimeve në kapacitetin e trafos ekzistuese, kompania sugjeroi ndërrimin e trafos dhe të shtyllave të rrymës afër fabrikës, të cilat janë vendosur që nga vitet 1960 dhe shpesh krijojnë probleme furnizimi gjatë erërave të forta.

KEDS miratoi vendosjen e një trafoje afër fabrikës, por refuzoi propozimin e kompanisë për të ndërtuar shtylla të reja pranë fabrikës, duke sugjeruar furnizim nga një distancë më e largët, që, sipas kompanisë, do të kërkonte ndërtimin e 50-60 shtyllave në terren malor dhe tokë private. Kompania propozoi një alternativë që përfshinte vendosjen e 12 shtyllave në tokë livadhi, ku

pronarët tashmë kishin dhënë pëlqimin për vendosjen e shtyllave. Si rezultat i mungesës së furnizimit të pamjaftueshëm me energji, kompania ka humbur një investim të majmë, që do të luante rol të madh në planet e saj për të dyfishuar prodhimin dhe për të hyrë në tregun evropian.

Ndërsa, një kompani tjetër ka treguar se ka pasur vështirësi për tre vite rresht në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për kyçje në rrjet për shkak të vonesave në marrjen e miratimeve nga institucionet publike përkatëse. Në këtë rast specifik, derisa afati për kyçjen i dhënë nga KEDS po afrohet aktualisht, dokumentacioni është ende i pakompletuar për shkak të këtyre vonesave. Kjo gjë rrezikon të çojë në ndryshimin e vendit të kyçjes, pavarësisht investimeve të mëdha të kompanisë në vendndodhjen aktuale. Një tjetër problem është se komunat lëshojnë leje pa konsultuar planin zhvillimor energjetik, duke rezultuar kështu në mungesë kapaciteti në pikën e kyçjes dhe detyrimin e kompanive për të bërë investime shtesë.

PJESA 2

Perspektiva e prodhuesve (gjeneruesve) të energjisë per kycje ne rrjet te transmisionit

Si sfidë e parë, përmes Ligjit Nr. 08/L-201 për plotësim-ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, të datës 9 gusht 2023, kërkohet që çdo marrëveshje e kyçjes duhet të jetë në përputhje me planet e Ministrisë së Ekonomisë, duke vendosur në prioritet interesin e shtetit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme të energjisë në prona publike, për të vendosur pastaj nëse biznesi mund të fillojë prodhimin e energjisë në atë pikë specifike. Bizneset e prekura nga ky ndryshim konsiderojnë se një gjë e tillë vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e investimeve të tyre, dhe se aprovimi i kërkuar nga Ministria e Ekonomisë zgjat kohën dhe kostot e zhvillimit, duke e bërë ambientin e biznesit më sfidues dhe më pak tërheqës për investitorët.

Një tjetër çështje e ngritur gjatë forumeve sektoriale ka qenë edhe mungesa e koordinimit më të mirë mes Rregullatorit dhe KOSTT sa i përket kyçjes së prodhuesve të energjisë në rrjet. Një përfaqësues i një rrjeti të bizneseve njoftoi për raste kur investitorët e huaj janë përballur me mungesë dokumentacioni të qartë dhe të plotë për procedurat e autorizimit dhe kyçjes. Kjo krijon konfuzion, sidomos kur institucionet kanë kërkesa kundërthënëse.

Kompanitë raportuan se kanë hasur probleme me marrjen e autorizimeve, pasi Rregullatori kërkonte marrëveshje paraprake me KOSTT, ndërsa KOSTT kërkonte autorizim nga Rregullatori për të nënshkruar marrëveshjen. Kjo ka nxitur kërkesën dhe rekomandimet nga bizneset për rregulla të qarta dhe të unifikuara mes institucioneve.

Përfaqësues nga një kompani tjetër gjithashtu raportuan për probleme gjatë kyçjes në kapacitete të rritura. Fillimisht ishin informuar nga KEDS se mund të kyçen në një zonë të përshtatshme, por kur erdhi koha e kyçjes, pas kryerjes së investimit, KEDS njoftoi se nuk kishte kapacitet të mjaftueshëm në atë linjë. Për pasojë, kompania u detyrua të investojë vetë në ndërtimin e kapaciteteve përçuese për rreth 7 km për të realizuar lidhjen.

Gjithashtu, është theksuar problemi i aplikimeve të shumëfishta për të njëjtën pikë kyçjeje, ku aplikuesit shpenzojnë deri në gjysmë milioni euro për kompletim të dokumentacionit, pa pasur siguri për nënshkrimin e marrëveshjes finale.

Kompanitë kanë propozuar riformulimin e procedurave ashtu që ato të ofrojnë më shumë siguri për investitorët, duke sugjeruar që marrëveshja të lidhet me aplikuesin e parë, i cili pastaj do të ketë afat 2-vjeçar për të plotësuar kushtet.

Sqarimi nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Në vijim të takimit të mbajtur në kuadër të KKEI/Forumiks, Rregullatori ka ofruar udhëzimet në bazë të Rregullës 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve Energjetike, e cila ka ndryshuar Rregullën paraprake. Sipas shpjegimit të dhënë, për procedurën e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, duhet të ndiqen hapat në vijim:

a) Investitori merr informatën teknike nga KOSTT-i;
b) Investitori pajisjet me Vendimin për Kushte Ndërtimore nga organi kompetent, në përputhje me Ligjin për Ndërtim;
c) Investitori lidh marrëveshjen për Kyçje me KOSTT, e cila e ka si parakusht pajisjen me Vendim për kushte ndërtimore;
d) Investitori (Aplikuesi) dorëzon në ZRRE aplikacionin për pajisje me autorizim për ndërtim, i cili përfshin edhe marrëveshjen e kyçjes.

Pra, me këtë u sqarua se investitori ka të drejtë të aplikojë në ZRRE për t'u pajisur me Vendim për Autorizim vetëm pasi të kompletojë dokumentet e nevojshme, përfshirë Vendimin për kushte ndërtimore (lejen ndërtimore) dhe marrëveshjen për kyçje me KOSTT.

Koment nga zhvilluesit e sistemeve fotovoltaike

Nga instaluesit e sistemeve fotovoltaike, kemi marrë input se 1) vonesat në vendime të ZRRE-së dhe 2) mungesa e qëndrimit të unifikuar për dhënien e pëlqimeve në nivel komunal, bën që

procesi i marrjes së autorizimit për ndërtim të zgjatet 2-8 muaj, duke krijuar një problem të madh për sektorin.

Një nga këto probleme është se disa komuna nuk lëshojnë pëlqime për projekte në çati (kulme) për shkak të mos-aprovimit të hartave zonale. Problem tjetër është se kërkesa për leje ndërtimi, statikë të detajizuar, pëlqim elektroenergjetik, dhe leje mjedisore dallojnë midis komunave si Gjakova, Vitia, dhe Prizreni, ku mungojnë udhëzimer e qarta për dokumentacionin e nevojshëm.

Zgjidhja e propozuar nga zhvilluesit është që për sistemet solare fotovoltaike (FV) deri në 200 kWh të mos kërkohet pëlqim nga komunat, pasi kjo është kompetencë e KEDS-it - siç veprohet për sistemet FV rezidenciale deri në 7 kWh.

Sipas informacionit që kemi, zhvilluesit janë takuar me Rregullatorin me c'rast ky i fundit është zotuar të takohet me Asociacionin e Komunave të Kosovës, me qëllim që të vendosin një shabllon unik për pëlqimet mjedisore, për përdorim në të gjitha komunat.

Korniza regullatore për kyçjen në rrjet të shpërndarjes

Rregullatori ka nxjerrë metodologjitë që rregullojnë modalitetet e shpërndarjes së energjisë elektrike. Janë dy dokumente kryesore që rregullojnë këto aspekte. I pari, Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzim dhe Taksave për Kycje në Sistemin e Shpërndarjes (2022) ("Parimet"), dhe, i dyti, Metodologjia e Taksave të Kyçjes të rrjetit të shpërndarjes (2022) ("Metodologjia").

Shpjegimet në vijim i referohen kryesisht kyçjes në rrjet nga kompanitë, jo domosdoshmërisht edhe konsumatorëve shtëpiakë.

Metodologjia e taksave për kyçje në rrjetin e shpërndarjes

Metodologjia përcakton taksat e kyçjes për dy kategori të ndryshme, së pari, taksat për kyçje në rrjet për aplikuesit e ri në rrjetin ekzistues, së dyti, taksat për ngritjen e kapacitetit të shfrytëzuesve aktualë. Për qëllime të këtyre kategorizimeve, kapaciteti efektiv nënkupton kapacitetin ekzistues në secilën pikë të rrjetit, i cili mund të shfrytëzohet nga aplikuesit pa cënuar kufizimet teknike të operimit të rrjetit.

- **Kategoria e parë,** quhet kyçje e cekët, pra, kyçje e konsumatorit në rrjetin e shpërndarjes, pa pasur nevojë për zgjerim apo përforcim të rrjetit ekzistues. Në këtë rast, aplikuesi mbulon vetëm ato kosto të cilat shkaktohen nga krijimi i një kyçje të re në pikën më të afërt e të përshtatshme të kyçjes.

- Ndërkaq, **kategoria e dytë**, e quajtur kyçje e thellë, nënkupton kyçjen në rrjet kur kapaciteti ekzistues nuk mjafton për nevojat e aplikuesit, e ka nevojë për zgjerim apo përforcim të rrjetit. Në këtë rast, aplikuesi do të mbulojë me shpenzimet e veta kostot e aseteve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në rrjetin ekzistues, taksën standarde për shërbim të kyçjes, taksën për zgjerim të kapacitetit (vetëm për pjesën e përforcuar), si dhe taksën e punimeve për ndërtimin e rrjetit (në rastet kur këto punime i kryen KEDS.

Taksa e kyçjes = Taksa standarde për shërbim të kyçjes + taksa për kapacitet + taksa indikative për punë për ndërtimin e rrjetit

Ndërkaq, sipas Parimeve për kyçje në rrjet të shpërndarjes, taksat për kyçje të thella nuk aplikohen në rast se përforcimi në fjalë parashihet në Planin Zhvillimor të Rrjetit të KEDS-it të aprovuar nga Rregullatori.[1] Megjithatë, nëse investitori nuk mund presë për implementimin sipas planit zhvillimor, mund të paguajë vetë për rritjen e kapacitetit të rrjetit në mënyrë të përshpejtuar.

Në anën tjetër, paraqiten edhe raste kur nevojitet edhe zgjerimi i sistemit të transmetimit. Në këto raste, taksat do të aplikohen si për rrjetin e shpërndarjes ashtu edhe për atë të transmetimit, përderisa KOSTT dhe KEDS do të koordinohen rreth shpërndarjes së kostove.[2]

Parimet e përcaktimit të taksave të KEDS, rregullojnë edhe çështjen e përparësisë në rast se dy apo më shumë konsumatorë kërkojnë të kyçen në të njëtën pikë të kyçjes. Në këto raste, kur ka shumë kërkesë për pikën ku kapaciteti nuk është i mjaftueshëm, apo ekzistojnë pengesa tjera në rrjet, atëherë KEDS i jep të drejtë kyçje aplikuesit të parë, ndërsa të dytit i propozon kyçjen në një pikë tjetër.[3]

Tutje, ky dokument ka paraparë edhe rastet ku përfshihet edhe zgjerimi i sistemit të transmetimit gjatë kyçjeve të thella. Në këto raste, taksat aplikohen për të dy rrjetet, përderisa operatorët e sistemit koordinohen rreth shpërndarjes së kostove.

Për fund, KEDS duhet t'i propozojë Rregullatorit për aprovim një deklaratë për taksa për kycje të llogaritura në përputhje me Metodologjinë, një herë në vit. Kjo i jep hapësirë për ndryshimin e nivelit të taksave po qe se paraqitet nevoja.

Procedura pas kyçjes dhe kompensimi i aseteve nga aplikuesit e rinj

---

[1] Parimet, Neni 12, para. 6; Metodologjia, Neni 12, para. 4.
[2] Parimet, Neni 19.
[3] Parimet, Neni 18.

KEDS na ka njoftuar se pas finalizimit të kyçjes në rrjet, aplikuesi bart shpenzimet për trafon dhe linjën deri te objekti i tij. Ekziston mundësia për kompensim të shpenzimeve për asetet e reja (në raste të kyçjesh të reja), por jo për ndërtesat kolektive.

Lidhur me kompensimin e aseteve nga aplikuesit e rinj, Metodologjia parasheh se në rastet kur asetet e kyçjes të paguara nga aplikuesi i mëhershëm (i parë) përdoren për kyçjen e një aplikuesi të ri, KEDS do të ngarkojë aplikuesin e ri me një taksë për vlerën e paamortizuar të aseteve dhe për kostot e kapitalizuara që tejkalojnë pjesën e mbetur të aseteve. Proporcionet e kostove do të përcaktohen sipas kapacitetit të dakorduar mes përdoruesve, ndërsa kompensimi do të realizohet përmes KEDS-it.[4]

Koment nga KEDS

Sipas pikëpamjes së KEDS, sfida kryesore është koncentrimi i madh i bizneseve në pika të caktuara, e që krijon kërkesë të madhe për energji, ndërsa investimet e KEDS nuk arrijnë të përmbushin këtë kërkesë në kohë. Plani investiv i KEDS aprovohet nga Rregullatori në përputhje me buxhetin e alokuar, por shpesh nuk aprovohet për shkak të mungesës së kapacitetit zhvillimor.

Si perfundim, KEDS-i investon përafërsisht 20 milionë euro në vit në përmirësime dhe zgjerime të rrjetit. Ky kufi vendoset për shkak të disa faktorëve. Një ndër këta faktorë ka të bëjë me kapacitetet e kufizuara te KEDS-it për të realizuar projekte që e kalojnë këtë vlerë. Edhe pse edhe investimet shtesë dhe signifikante mbi këtë vlerë mund të çojnë deri tek rritja e tarifave, kjo nuk duket të jetë arsyeja kryesore pse nuk ka investime shtese mbi 20 mil, pasi qe Rregullatori ka reflektuar me zbritje të tarifave në muajin prill të vitit 2024.

Disa kompani, në varësi të vendndodhjes së tyre, e kanë më të lehtë të lidhen me rrjetin ekzistues, ndërsa të tjerat duhet të investojnë në ndërtimin e linjave të reja të rrjetit ose nënstacioneve për të pasur qasje në një furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike.

Kjo situatë rezulton në një sistem të dyfishtë - paralel:

1. KEDS-i investon deri në 20 milionë euro në vit, me kosto të reflektuara në tarifat e konsumatorit.
2. Bizneset janë të detyruara të investojnë në zgjerimet e rrjetit përtej këtij kufiri, pa reflektuar këto investime në tarifa.

[4] Metodologjia, Neni 16.

Në mënyrë efektive, kompanitë jo vetëm që po financojnë zgjerimet e rrjetit në mënyrë të pavarur, por gjithashtu po konkurrojnë me burimet dhe kapacitetin operativ të KEDS-it. Puna që ata kryejnë - shpesh përmes kontraktimit të zhvilluesve më të vegjël - është paralele me atë që do të bënte KEDS nëse punësonte kontraktorë të jashtëm për të njëjtin qëllim. Prandaj, nga këndvështrimi i këtyre bizneseve, kjo situatë aktuale duket e padrejtë.

Rekomandimet

Për adresimin e çështjeve të përmendura më sipër, Sekretariati i KKEI, përmes forumeve sektoriale dhe tematike, ka mbledhur rekomandime për të lehtësuar procesin e kyçjes në rrjet dhe për të trajtuar sfidat me të cilat përballen bizneset. Këto masa përfshijnë përmirësime në koordinimin institucional, reforma rregullatore dhe strategjike, si dhe zgjidhje konkrete teknike dhe infrastrukturore. Rekomandimet kanë për qëllim krijimin e një ambienti më të favorshëm për investime, rritjen e transparencës dhe efikasitetit të procedurave, dhe lehtësimin e sfidave që pengojnë kyçjen e bizneseve në rrjetin e energjisë elektrike.

Rekomandime teknike

1. Rregullatori dhe operatorët e sistemit të koordinohen mes vete lidhur me kërkesat e bizneseve për këtë çështje;
2. Operatorët e sistemit (KEDS dhe KOSTT) të mbajnë konsultime për plane zhvillimore me palët e interesit, dhe këtë ta raportojnë saktësisht në raportet e publikuara për planet.

Rekomandime lidhur me legjislacionin në fuqi

3. Të harmonizohet dhe unifikohet procedura e aplikimit për kycje në rrjet të shpërndarjes dhe transmisionit, në nivel lokal dhe nivel qëndror;

Rekomandime konkrete – projekte

4. Krijimi i një portali (harte) interaktive për të parë pikat e mundshme për kycje si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.
5. Krijimi i një one-stop-shop që merret vetëm me cështjet e energjisë – ua lehtëson punën bizneseve sidomos kur ka shpërputhje në korniza ligjore.
6. Draftimi i një udhëzuesi gjithpërfshirës për bizneset lidhur me kycjen në rrjet, apo edhe më gjerë në sektorin e energjisë – kjo të realizohet përmes formimit të një grupi punues që do të punonte në këtë drejtim.

Reforma rregullatore/strategjike

7. Komuna t'i mbulojë shpenzimet e ndërtimit të infrastrukturës, kycjes në rrjet, dhe aseteve të nevojshme në rast se e jep lejen ndërtimore. Këto kosto t'i faturohen komunës direkt nga KEDS. Një reformë e tillë do të inkurajonte legalizimin e objekteve të ndërtuara, gjegjësisht të dekurajonte ndërtimin e objekteve pa leje.

8. Nëse projekti/konsumatori ka ndikim të madh në ekonominë e shtetit, punësim etj., atëherë të aplikohet njëri nga këto opsione:
    a. Rregullatori ta pranojë koston e KEDS-it si investim *ad hoc* (si devijim prej planit aktual zhvillimor); ose
    b. Qeveria apo komuna përkatëse, ta marrë përsipër pagesën nëse ajo pikë e kycjes nuk është në planin zhvillimor të KEDS-it; ose
    c. Të bëhen ndryshime rregullatore që mundësojnë reflektimin e investimeve të bëra nga kompanitë për zgjerimin apo përmirësimin e rrjetit elektrik në tarifën e energjisë elektrike për ato kompani. Kjo do t'u mundësonte kompanive që të kenë përfitime financiare nga investimet e tyre dhe do të nxisë më shumë angazhime në përmirësimin e infrastrukturës energjetike.

9. Trajtim i barabartë për bizneset dhe Qeverinë në lidhje me kyçjen në rrjetin e transmetimit: KOSTT duhet të trajtojë në mënyrë të barabartë kërkesat e Qeverisë dhe bizneseve për kyçje në rrjetin e transmetimit, duke mos i dhënë përparësi Qeverisë. Ky parim i barazisë do të rriste konkurrencën, do të siguronte qartësi për bizneset dhe do të shmangte vonesat që shkaktohen kur KOSTT pret përgjigje nga Qeveria për rezervimin e një pike kyçjeje.